

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.G., nga Peja, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të dëmtuarit F.R., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.1054/2017, të datës 08.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.01.2019, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e dëmtuarit F.R., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.1054/2017, të datës 08.05.2018, **vërtetohet**.

II. Hudhet si e pa lejuar ankesa e të dëmtuarit, sa i përket bazës ankimore-shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.1054/2017, të datës 08.05.2018, është shpallur fajtor i akuzuari M.G., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi më kusht duke i vërtetur dënimin më burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet poqë së i dëmtuari në afatin e verifikimit brenda 1(një) viti nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

I akuzuari është obliguar që të paguaj shpenzimet procedurës penale në shumën prej 20€ (njëzet), paushallin gjyqësor në shumë prej 15€ (pesëmbëdhjete), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i dëmtuarit F.R., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe vendimi lidhur më sanksionin penal, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta anuloj aktgjykimin e ankimuar ose që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më ashpër, mundësisht dënim më burgim efektiv.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.1279/2018, të datës 31.12.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e të dëmtuarit F.R., ka propozuar që e njëjta të aprovohet vetëm pjesërisht, përkitazi më vendimin për dënim, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më burgim efektiv, ndërsa sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të hudhet si e pa lejueshme.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e të dëmtuarit F..R., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së të dëmtuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin duke theksuar se në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar ën masë të duhur të gjitha rrethanat në rastin e marrjes së vendimit për dënimin dhe gjithashtu ka theksuar se i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupor e jo lëndime të lehta trupore për të cilat gjykata e shkallës së parë nuk është kujdesur. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat tjera, sikurse është se ma ka pamundësuar që të marr pjesë në gjykim, andaj i propozoj gjykatës që ti shqiptohet dënimi më burgim efektiv.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi më vendimin për dënimin, dhe ka ardhur në përfundim, se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të aktgjykimit, vie në përfundim se në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale, se vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, kurse rrethana rënduese në këtë çështje penale nuk gjeti, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, sikurse pretendon i dëmtuari në ankesën e ushtruar, kolegji i kësaj gjykatë, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës shkallës parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

I dëmtuari ka ushtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mirëpo për këtë bazë ankimore i njëjti s'mund të ushtroj ankesë në kuptim të nenit 381 par.3 të KPPK, sepse mund të ushtroj vetëm për shkak të vendimit për dënimin, andaj për këtë bazë ankimore, ankesa është hudhur si e pa lejuar në kuptim të nenit 400 të KPPK.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1276/2018 të datës 14.01.2019**

**B. profesionale
Leonita Lajçi**

**Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani**

Biljana Rexhiq